

V E N D I M
Nr.400, datë 22.8.1994

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.314, DATË
30.6.1993 “PËR RREGULLIMIN E KOHËS SË PUNËS DHE TË PUSHIMIT NË MINISTRI,
INSTITUCIONET E TJERA QENDRORE DHE ORGANET E PUSHTETIT LOKAL”**

Në zbatim të ligjit nr.7724, datë 22.6.1993 “Për rregullimin e kohës së punës dhe të pushimit”,
Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.314, datë 30.6.1993 “Për rregullimin e kohës së punës dhe të pushimit në ministri, institucionet e tjera qendrore dhe organet e pushtetit lokal”, pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“Për punëmarrësit që punojnë në ndërresat e dyta dhe të treta caktohet shtesë page në masën 20 për qind dhe 50 për qind e pagës për kohën e punës të ndërresës së parë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi